



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANIA
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770
E-MAIL: info@neon.al WEB: www.neon.al

**NEON RS COLOR PAINT
(PIGMENT RS)
PIGMENT PËR LYERJE MURI
Skedë Teknike**

PËRSHKRIMI: RS COLOR PAINT përdoret për lyerje fasadash dhe ambiente të brendshme ose për ngjyrosjen e bojrave të bardha sipas katalogut NEON. Ai përbëhet nga rezinë PVA VEOVA të një cilësie të lartë. Është i Përshtatshëm për sipërfaqe të stukuara, betonuara, çimentuara etj. Sipërfaqja e lyer pasi të jetë tharë mirë për rreth 15 – 20 ditësh, mund të pastrohet me solucion pastrues, të shpërlahet tërësisht me ujë të pastër dhe mund të thahet pa shkaktuar fshirjen e bojës.

FUSHA E PËRDORIMIT: RS COLOR PAINT është e përdorshme në mjedise të jashtme dhe të brendshme,

NGJYRAT: E zezë, kafe, e verdhë, çokollatë, jeshile, okër, e kuqe, blu dhe portokalli.

PARAPËRGATITJA: Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet (shtresat e fryra). Në sipërfaqet e reja duhet të kalohet paraprakisht një dorë astari plastik PN – 301 i cili hollohet me ujë deri në masën 30% ose me astar plastik PN – 101 i cili është i gatshëm për përdorim.

PËRDORIMI: Përgatitet boja duke i shtuar ujë deri në konsistencën e kërkuar. Për të realizuar një lyerje të mirë, duhet të aplikohen dy duar RS COLOR PAINT. Për dorën e parë hollimi i bojës me ujë duhet të jetë në masën 10%. Pas 2 – 4 orësh aplikoni dorën e dytë. Lyerja aplikohet lehtësisht me rrul ose furçë.

KUJDES: Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe në kushte të larta lagështie të mjedisit. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5⁰C. Pas përfundimit të lyerjes pajisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....sipas katalogut
- Koha e tharjes.....2 - 4 orë

REZIKSHMËRIA: Bojrat me bazë ujore të “NEON sh.a” kanë përbërës që nuk klasifikohen si të rrezikshëm mbështetur në Direktivën 1999/45/EC.

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kova plastike 0.375L dhe 0.75L.